



01/Nr. 5745/2020  
Data: 24.08.2020

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e pestë -V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 14.07.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtore për Buxhet dhe Financa), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve të Kompanisë "Pastrimi") Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hani të Elezit.
3. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2020.
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm i Komunës së Hani të Elezit.
5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hani të Elezit.
6. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2021.
7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për gjashtë mujorin e N.P.L "Pastrimi" sh.a.
8. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2020.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- para se me proceduar me pikat e rendit të punës, ju njoftojë se sot kemi pasur takim me shefat e grupeve parlamentare dhe kanë arritur pëlqimin që të dalin me një deklaratë për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së, andaj propozoj që në emër të anëtarëve të kuvendit ta lexon deklaratën z.Mehmet Ballazhi.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- me shefat e grupeve parlamentare u pajtuan që si kuvend komunal me dal me mbështetje të deklaratës, e në këtë rast në mbështetje të krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

### DEKLARATË

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës kundër regjimit gjenocidal të Slllobodan Millosheviqit, forcave ushtarake, policore e paramilitare të Serbisë në Kosovë.
2. Vlerësojmë të paprecedent veprimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të publikuar njoftimin për një aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.

3. Shprehim shqetësimin se ky veprim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe është në kundërshtim të plotë me parimin themelor të drejtësisë, atë të prezumimit të pafajësisë.
4. Ritheksojmë se lufta mbrojtëse e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë. Ajo nuk mund të njolloset asnjëherë. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, përfshirë Dhomat e Specializuara. Në gjithë këto procese është dëshmuar pastërtia e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi.
5. Njohim dhe vlerësojmë lart sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur nga NATO, e të udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri mbështetjen e plotë për z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe shprehim besimin e palëkundur për pafajësinë e tyre.
6. I konsiderojmë përpjekje të padrejta dhe të rrezikshme, por të përealizueshme, tendencat për ta kriminalizuar luftën e drejtë dhe të lavdishme të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Refuzojmë çfarëdo përpjekje për ta etiketuar UÇK-në si agresore;
7. E vërteta për historinë e popullit shqiptar nuk mund të deformohet dhe as të tjetërsohet nga ata që pretendojnë për t'i barazuar viktimat me kryesit e krimeve serbe. Kosovën nuk mund ta dobësojë askush dhe të ardhmen e saj euroatlantike nuk mund ta devijojë dhe as ta ndalë asnjë përpjekje.
8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje për unitet mes njerëzve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet partive politike për të ruajtur shtetin e Kosovës, vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**Kryesuesi** thekson:- deklaratën të cilën e lexoj z. Mehmet Ballazhi e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- kur ka të bëjë për çështje madhore kuvendi i komunës së Hanit të Elezit asnjë herë nuk i ka shikuar interesat partiake por çdo herë ishin unikë për çështje madhore. Nga data 02.07.2020 kemi pasur rastin e tetë me koronavirus, ndërsa me datë 06.07.2020 janë shënuar edhe dy raste me koronavirus. Kohët e fundit nuk janë duke ju bërë teste sikur më herët çdo personi që ishte i dyshuar apo personi kontakti. Me vendim të ministrit është potencuar që testet duhet ti bëhen vetëm personave të cilët kanë simptoma sepse nuk ka mundësi për shkak të numrit të madh që është paraqitur. Prej UNMIK-ut kemi pasur donacion me maska dorëza dhe disa tabletë për nxënës. Nëse keni ndonjë pyetje rreth kësaj pike të rendit të punës mund të parashtroni.

**Nora Xhoni** thekson:- a keni evidencë për ata persona të cilët kanë simptoma që së paku nëse nuk mundën me bërë testin përmes organeve të rendit me ju rekomanduar për vetizolim.

**Sabrije Krasniç** thekson:- a ka familje të izoluara në Komunën e Hanit të Elezit apo vetëm personat të cilët janë me virus.

**Sabedin Hasallari** thekson:- si qëndron puna për udhëzimin e qytetarëve për me bërë teste a vetëm ata të cilët janë të sëmur dhe paraqiten në ambulantë për shkak se qytetarët po hezitojnë me shkuar te mjeku.

**Rufki Suma** thekson:- rasti i parë që është paraqitur në ambulantë mjeku i ka sugjeruar me shkuar me bërë testin për shkak se ka pasur elemente të koronavirusit dhe personi ka refuzuar me shkuar sepse ka potencuar që më ka sugjeruar mjeku i mushkërive që ke problem me mushkri. Në momentin që ka pasur dhimbje më shumë e kanë dërguar me ndihmë të shpejtë. Rasti tjetër ishte që kanë ardhur prej pushimit dhe kanë pasur simptoma. Teste janë duke ua bërë rasteve urgjente.

**Florim Shkreta** thekson:- në takimin e fundit që e keni pasur me gjithë kryetarët e komunave është diskutuar për disa masa, a vlejnë për të gjitha komunat njëjtë apo varësisht prej komunës siç është rreziku i epidemisë

**Rufki Suma** thekson:- në atë takim nuk kam marr pjesë që kryeministri i ka informuar kryetarët e komunave dhe kjo është bërë përmes internetit fillimisht ishin komuna e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajit por tash është shtuar edhe komuna e Gjilanit dhe disa komuna të tjera dhe këto masa vlejnë pas orës 21:00. Çështja e lëvizjes nuk vlen për Han të Elezit, ndërsa restorantet dhe disa biznese të tjera nuk kanë drejtë me punuar pas orës 21:00 në tërë Kosovën pavarësisht a janë brenda kësaj liste apo nuk janë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

## 3. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- shpenzimi për periudhën janar-qershor 2020, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve është në shumë prej 1,068,185.70 € apo 36.34% e planit të përgjithshëm vjetor. Pagesat nga kategoria ekonomike pagat dhe mëditjet janë 768,907.83 € ose 50.02% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 pagesat për këtë kategori kemi rritje për 4.98% apo 36,490.12 €. Pagesat për këtë kategori ekonomike mallra dhe shërbime për 6 mujorin e parë 2020 janë 126,562.94 € apo 38.45% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi një shpenzim më të madh për 22,868.48 €. Pagesat për shpenzime komunale gjashtëmujorin e parë 2020 janë në shumë prej 22,500.10 € apo 37.50% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi rritje për 899.87 € apo 4.17%. Pagesat

nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere për gjashtëmujorin e parë 2020 janë në shumë prej 34,300.00 € apo 42.22% e planit vjetor. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2019 kemi një shpenzim më të vogël për 16,033.80 €. Pagesat nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale janë në shumë prej 115,914.83 € apo 15.20% e planit vjetor. Të hyrat vetanake për këtë periudhë gjashtëmujore 2020 janë realizuar në shumë prej 127,951.20 € apo për 41,986.88 € më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Nora Xhoni** thekson:- faqe 13 tabela pesë te mallrat dhe shërbimet avanc për para të imta për vitin 2020 është në shumë prej 13 680.00 €, ndërsa për vitin 2019 ishte në shumë prej 5581.00 €. Kërkoj sqarim.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- po që se krahasohen shpenzimet me gjashtë mujorin e vitit të kaluar shihet se janë rritur. Nëse krahasohen shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe disa shpenzime tjera janë më të mëdha në krahasim me shpenzimet kapitale, mirëpo është dashur që shpenzimet kapitale të janë më të mëdha në krahasim me shpenzimet e tjera të cilat u përmendën.

**Teuta Shkreta** thekson:- kërkoj sqarim te tabela numër pesë shpenzimet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Është shënuar për anëtarësimin në odën e mjekëve të Kosovës por me sa e di unë kemi vetëm odën e infermierëve në komunën tonë.

**Sabrije Krasniqi** thekson:- a ekziston mundësi që me rregulluar Lumin Lepencë në vendin e quajtur Kashan për shkak se ishte një vend shumë i mirë. Do të ishte mirë me rregulluar si pushimore për banorët e Hanit të Elezit. Është mirë me u bërë pastrimi dhe rregullimi i kroit në fshatin Paldenicë . A mundet përmes donatorëve me u bërë rregullimi i banesave sociale në Han të Elezit sepse ka shumë banorë që kanë nevojë për banim. Për furnizim me ujë për banorët e Hanit të Elezit është mirë të konsultoheni edhe me fshatarët sepse ata e dinin se në cilat vende ka burime të ujit.

**Mefail Suma** thekson:- kam dëgjuar se keni dashur më bërë rregullimin e kroit në fshatin Dimcë por nuk e di sa është e vërtetë por kërkoj që të futet në projekt dhe të rregullohet sepse një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që mbushin ujë për pije. Shtrimi me kupëza betoni nëpër zonat rural qe dhjetë vite figurën në këtë mënyrë dhe është mirë pak më në detale me i paraqitur. Janë shpenzuar 55 000 € por në fshatin Dimcë nuk është investuar asgjë dhe më herët kam kërkuar që raporti financiarë më në detale të jetë. Pse nuk barazohet shpenzimet kapitale që i ka paraqitur auditori me shpenzimet kapitale të cilat i keni paraqitur ju në raport.

**Sead Vila** thekson:- s ai përket shpenzimeve a keni planifikuar në gjashtë mujorin e dytë një zhvillim të dinamikës më të shpejtë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- pse është kjo rënie te shpenzimet e subvencioneve në krahasim me vitin paraprakë.

**Florim Shkreta** thekson:- rrugët të cilat po shtrohen me kupëza betoni thuhet që vetëm deklaroni që mbetet rrugë publike dhe ta shtrojmë oborrin dhe nuk e di si llogaritet rrugë publike kur i ka vetëm katër apo pesë metra dhe nuk ka dalje ajo rrugë. A ka drejtë qytetarët ta shfrytëzojnë atë rrugë që shtrohet me kupëza betoni prej komunës.

**Rufki Suma** thekson:- rrugën publike ka të drejtë kushdo për me shfrytëzuar dhe rrugën publike mund ta bëjnë katër apo pesë vëllezër të cilët jetojnë në atë Lagje. Viteve të tjera subvencionet i kemi kryer deri në muajin qershor ,ndërsa në këtë vit jemi në procedurë të dhënies së subvencioneve për kulturë dhe bujqësi. Ridestininim të mjeteve financiare për projekte do të ketë . Edhe pse ka qenë pandemi punimet kanë vazhduar në realizimin e projekteve. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve shumica e faturave të vitit të kaluar janë paguar në këtë vit për shkak se viti i kaluar ishte vit jubilarë . Ne e kemi planifikuar si kod ndërtimin e banesave sociale duke e llogaritur se kur po ndërtojmë shtëpi sociale dhe në momentin që kemi dashur me ju ndihmuar na është sugjeruar prej Ministrisë që nuk keni të drejtë prej kësaj kategorie por vetëm prej subvencioneve .

Shoqata humanitare që japin donacione të ndryshme nuk merren me ndërtime të banesave por me shtëpia individuale që e vlerësojnë që ka nevojë. Kroi në fshatin Paldenicë është kroi i parë që është investuar prej komunës dhe kompania mundet me i pastruar mbeturinat por mirëmbajtje të përditshme nuk mundet me bërë. Te Kashani jemi munduar me bërë zonë pushimore por ka kërkesa që me ndërtuar restorante dhe çdo kërkesë që është në interesin tonë e miratojmë. Kroin e fshatit Dimcë kemi dashur me rregulluar para katër apo pesë viteve por burimi i ujit del në pronë private dhe vendi i kroit ndoshta është publike por afër është prona private. Nëse banorët dakordohen që në atë vend me rregulluar ne mundemi me vendosë ndonjë pllakë, mirëpo më mirë pronari me lëshuar pronën pak dhe me bërë më mirë.

**Mefail Suma** thekson:- qeshma ka dalë poshtë dhe për me pijë ujë është dashur me ulë poshtë dhe është ndal kur është ndërtuar shtëpia e vjetër dhe është mirë të rregullohet se ai ujë është ndalë herët, është shitur dhe e ka blerë një ndërmarrje nga Kaçaniku dhe më vonë ka ardhur kryetari i atëhershëm i komunës së Kaçanikut dhe ka bërë marrëveshje që aj ujë është liruar për me qenë i përhershëm i Dimcës e jo kujt i tekët me ndal atë ujë dhe me lëshuar. Atij burimi të ujit është mirë me i bërë rezervar në mënyrë që mos me rrjedh rregullisht uji. Është mirë të bisedoni me atë person për këtë çështje sepse po kemi dëshirë me bërë mirë atë vend.

**Shabi Rexhallari** thekson:- sa i përket avancave bëhet fjalë për faturat të cilat janë nën 100 €. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit ka të bëjë transporti i stafit për në Maqedoni për përgatitjen e planit zhvillimorë komunal. Krahas pagesës që bëhet për anëtarësimin e infermierëve paguhet edhe anëtarësi edhe për odën e mjekëve. Sa i përket shpenzimeve kapitale nëse krahasohet periudha janar –qershor shpenzimi është 15 % dhe e njëjta ishte edhe në vitin e kaluar. Për raportin e shpenzimeve kapitale te raporti i auditorit ka të bëjë me vitin 2019.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër (nga grupi parlamentarë nisma). Prezent ishin 14 këshilltarë të kuvendit të komunës.

#### **U MIRATUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR- QERSHORE 2020**

#### **4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm i Komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- sa i përket Raportit të Auditimit të Brendshëm të komunës së Hanit të Elezit, ne e dimë që komuna nuk ka auditor të brendshëm apo nuk e ka të themeluar njësinë e auditimit të brendshëm, ndërsa nga Qeveria e Kosovës është miratuar një rregullore në muajin janar 2019 që potencon që komunat që kanë nën 3 (tre) milion euro buxhet auditimin mund ta kryejnë përmes Departamentit të auditimit të Ministrisë së Financave. Ne si komunë kemi bërë kërkesë në Ministri të Financave - Departament të auditimit dhe ata na kanë futur në planin e vet për auditim dhe pastaj kanë ardhur në komunë nga muaji shkurt deri maj 2020 dhe e kanë bërë auditimin për vitin 2019 që nga organizimi dhe funksionimi i komunës, buxheti, shpenzimet, prokurimi, menaxhimi i pasurisë, investimet kapitale. Gjatë këtij auditimi ata i kanë dhënë edhe 4 rekomandime dhe ato janë:

**Rekomandimi 1:** Komuna e Hanit të Elezit të analizoj dhe ti arsyetojnë kërkesat e tyre për mbështetje financiare për plotësimin numrit të punëtorëve. Të kërkohej aprovimi i tyre në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në Ministrinë e Financave dhe Transfereve (MFT) dhe në Komisionin për buxhet dhe financa të Kuvendit të Kosovës.

MFT ta shqyrtojë kërkesën e Komunës së Hanit të Elezit me qëllim të funksionalizimit të çerdhes së fëmijëve dhe në shtimin e numrit të punëtorëve profesional në Qendrën Kryesore Mjekësisë Familjare.

**Rekomandimi 2:** Zyrtarët përgjegjës ta plotësojnë sistemin me të dhënat e nevojshme që të ketë gjurmë të mjaftueshme për zhvillimin e projektit deri në përmbyllje. Të kërkohej nga Ministria e Financave - Departamenti i buxhetit për qasje të zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e të dhënave në sistem.

**Rekomandimi 3:** Menaxheri i kontratës ta plotësoj formularin "Planin e menaxhimit të kontratës" sipas hapave në formular.

Menaxheri i prokurimit të monitoroj planin e menaxhimit të kontratës me qëllim që ta përmbyll aktivitetin e prokurimit me të dhënat e domosdoshme.

**Rekomandimi 4:** Menaxhmenti i Komunës të ngritë kontrollin në menaxhimin e pasurisë duke i freskuar të dhënat në regjistrat e pasurisë. Të themeloj dhe të kërkoj raporte nga komisioni i inventarizimit, vlerësimit, tjetërsimit, asgjësimit të pasurisë dhe të dijë vlerën e saktë të pasurisë financiare.

Në bashkëpunim me Thesarin dhe MAP të cilët menaxhojnë dy sistemet e regjistrimit të pasurisë të kërkojnë informata rreth rivlerësimit të pasurisë. Këtu te sistemi e-pasuria kemi pasur një problem që zyrtaret tone nuk kane pasur qasje deri ne fund te vitit sepse ato nga ana MAP-it e kane bere integrimin e sistemit nga aktual ne sistem me te avancuar dhe nuk kemi mundur qe te bëjmë regjistrimin e pasurisë me amortizim.

**Mefail Suma** thekson:- sipas rekomandimit të katërt është se ende figurojnë mjete themelore dhe ende kanë zero valorizimi dhe si e konsideroni që një mjetë themelorë ka rënë në zero valorizim , ndërsa në anën tjetër e shfrytëzoni dhe e vëni në funksion, a shkohet në formë të komisionit forma e përqindjes së valorizimit.

**Shabi Rexhallari** thekson:- kemi dy sisteme për menaxhimin e pasurisë që janë pasuritë mbi 1000 € dhe nën 1000 €. Te pasuria nën 1000 € nuk është bërë vlerësimi sepse qasjen nuk e kemi marr dhe nuk kemi pasur zyrtarë. Në këtë vit mendojmë me filluar, e zyrtari do të shënon të dhënat në kompjuterë dhe në mënyrë automatike sistemi e bënë vlerësimi. Te pasuria mbi 1000 € për të gjitha janë në sistem.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

#### **5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,.

**Shabi Rexhallari** thekson:- sa i përket planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit komuna ka caktuar një komision për përgatitjen e planit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga raporti i auditimit të brendshëm me afatin kohor dhe përgjegjësit kryesor për zbatim të rekomandimeve. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

#### **6. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- në vitet e kaluar jemi dakorduar që në grup punesë të jenë anëtarët e Komitetit për Politik e Financa, mirëpo në mbledhje të Komitetit për Politik e Financa u dakorduar që pjesë e grupit punues të jetë edhe z.Mefail Suma nga grupi parlamentar Nisma dhe z. Sead Vila i pavarur. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sead Vila** thekson:- do ta jap kontributin në këtë grup punues edhe pse në planin zhvillimorë i vetmi unë jam anashkaluar por në çështjet që janë me interes publik sa më shumë që bëhet shtrirje kontributi do të jetë më i madh.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Prezent ishin 14 këshilltarë të kuvendit të komunë.

**U MIRATUA THEMELIMI I GRUPIT PUNUESË PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021**

## 7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për gjashtë mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka tjetër me shtuar nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- kur do të fillojnë kontinierët me u shpërnda. Përqindje e madhe e kontinierëve janë amortizuar dhe mendoj që duhet të ndërrohen. Është pak problem se shumica e kontinierëve po dëmtohen prej punëtorëve gjatë zbrazjes së kontinierëve dhe duhet që punëtorët të jenë të kujdesshëm.

**Mefail Suma** thekson:- pavarësisht se a i kanë të dëmtuar qytetarët kontinierët për mbeturina është mirë që të furnizohen të gjithë në mënyrë që mos të bëhen dallime.

**Kujtim Dernjani** thekson:- kanë filluar me u shpërndarë kontinierët. Duhet ta kemi parasysh që kontinierët dhjetë vite i kanë bërë dhe janë amortizuar. Nëse punëtorët e kanë dëmtuar pa qëllim kontinierin dhe personi është ankuar kompania ja ka kompensuar. Me kontinier do të furnizohen të gjithë .

**Nora Xhoni** thekson:- unë mendoj që edhe qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm gjatë hedhjes së mbeturinave. Fillimisht shpërndarja e kontinierëve duhet të bëhet për ata familje që janë pagues të rregullt.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- nuk është mirë që të fajësohen shumë punëtorët për shkak se ata janë duke e bërë një punë shumë të mirë dhe duhet të falënderohen për punën që e kanë bërë në këtë kohë pandemie . Nëse nuk shpërndahen kontinierët për të gjitha familjet a mendoni se keni me pasur probleme sepse mund të ketë ankesa nga ata familje që nuk marrin.

**Kryesuesi** thekson:- edhe në KPF kemi potencuar që jemi shembull për kompaninë kemi lëvdata por dobësitë që janë duhet të sqarohen.

**Teuta Shkreta** thekson:- është mirë që punëtorët të kenë përgjegjësi sepse qytetarët hedhin mbeturina të ndryshme dhe duhet të sistemohen edhe mbeturinat.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- unë mendoj që mos të bëhen dallime të shpërndarja e kontinierëve sepse qytetarët nëse nuk i paguajnë mbeturinat dy muaj pastaj janë të obliguar me i paguar për shkak se nuk i kryen shërbim kompania. A do të vendosen shportat mbeturinave edhe në Fshatin Seçishtë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- qytetarët të cilët kanë obligime ndaj kompanisë pa i kryer obligimet mos me i pajisur me kontinierë. Shportat e mbeturinave në Lagje të re janë vendosur nga disa të rinj të Lagjes. Te performanca keni treguar suksese dhe jeni për lëvdata sepse në kohë pandemi kanë ngritje të hyrave , mirëpo shpenzimet janë rritur dhe është mirë me pasur kujdes.

**Sead Vila** thekson:- në rrugën “Imri Curri” nëpër disa shtylla ne të vendosen shportat për mbeturina sikurse në rrugën kryesore sepse i takojmë zonës së parë urbane . Shumicës së raporteve të cilat dërgohen në kuvend shihet që i përgjigjet dikush shkresave dhe është mirë që në të ardhmen të jetë emri i shënuar se kujt i takon dokumenti në fjalë e jo të jetë vetëm grupi i aksionarëve.

**Florim Shkreta** thekson:-punëtorët nuk duhet të fajësohen por me ju sugjeruar që duhet me pasur kujdes nuk është asgjë e keqe sepse ka raste që disa kontinierë punëtorët për shkak të pakujdesisë e ka dëmtuar. U potencua që ata të cilët kanë obligime ndaj kompanisë mos me i pajisur me kontinierë të rijë por është një diskriminim sepse dikujt në fund të muajit merr ndonjë pagë e ndoshta dikush nuk merr asgjë. Një ndër të parë duhet të jenë ata të cilët i kanë nënshkruar kontratat nga fillimi dhe unë mendoj që obligimet patjetër ka me i paguar, nëse e kalon afatin e pagesës janë organet e tjera përmbarimore apo mënyra të tjera, por j me bërë dallime për shkak se ka obligime pa paguara e mos me ja dërguar kontinierin sepse mund të revoltohen qytetarët.

**Nora Xhoni** thekson:- afër 900 kontinierë janë që do të shpërndahen dhe kontrata familjare janë 1247 dhe është mirë tu epet një privilegj atyre që i paguajnë rregullisht.

**Kujtim Dernjani** thekson:- kontinierët do të shpërndahen me rendë për të gjithë qytetarët . Sa i përket vendosjes së shportave për mbeturina në rrugën “Imri Curri” do të shqyrtohen mundësitë buxhetore për këtë çështje . Sa i përket mbeturinave të ndryshme që i hedhin qytetarët ata të cilët e njoftojnë kompaninë ua merr mbeturinat. Ka raste që edhe kamioni i dëmton kontinierët sepse punëtorëve u është dhënë vërejtje që të kenë kujdes. Shkresa bëhet në emër të komisionit të aksionarëve kryesuesi e bënë shkresën e nënshkruan e protokollon në sektorin e kuvendit të komunës dhe e përcjell për KPF dhe Kuvend.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

## **8. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- gjatë këtij viti janë mbajtur vetëm katër mbledhje dhe për dy mbledhjet të cilat nuk janë mbajtur diçka që ka pasur e kemi diskutuar në shtabin emergjentë . Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- është mirë të bisedohet me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” që mos me bllokuar pjesën e rrugës nga kamionët.

**Florim Shkreta** thekson:- në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi nuk po diskutohen temat të cilat janë për me u diskutuar. Secilën pikë që e kanë diskutuar nuk ka pasur ndonjë rast pozitiv që me potencuar që e rregulluam një çështje. Nuk është diskutuar rasti vandal që ndodhi te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” . Nuk është diskutuar për punimet që janë tu realizuar në rrugën e Gorancës sepse dheu e ka hedh në prrue të Rezhancës e në të ardhmen mund të jetë rrezik për banorët e Lagjes së Re. Nuk është diskutuar për fëmijët të cilët rrinë në rrugë te kufiri. Për çështje të qenve endacak nuk është diskutuar. Që do të thotë se nuk është zgjedhur asnjë rast për të cilat është diskutuar.

**Rufki Suma** thekson:- për çështjen e kamionëve të kompanisë “Sharrcem” rregullisht kemi biseduar dhe i kemi dërguar vërejtje. Para një viti kemi kërkuar që me shtruar asfalt pjesën ku i parkojnë kamionët por kanë potencuar që jemi tu e larguar parkingun nga ai vend dhe do të jetë vetëm në vitin 2019. Në kesi situata kur kemi ndonjë vërejtje njoftohet policia. Në mbledhje të KKSBB janë biseduar të gjitha çështje të cila u përmendën nga parafolësi. Rreziku që janë tu zhvilluar punimet te rruga e Gorancës është biseduar dhe ishim në teren i kemi sugjeruar që me i hequr gurët për shkak se rrezikohet Lagja e Re dhe kompania ka potencuar se pasi të kryhen punimet ne pjesën e sipërme do pastrohet pjesa e poshtme . Për këtë çështje është e njoftuar me shkrim Ministria përgjegjëse.

**Sabedin Hasallari** thekson:- kur do të fillojnë punimet për hapjen e rrugës nga Lagja e Re deri te Hasallarët.

**Rufki Suma** thekson:- për hapjen e rrugës nga Lagja e Re deri te Hasallarët kanë përfunduar procedura e prokurimit.

**Teuta Shkreta** thekson:- kamionët të cilët e shkaktojnë kolonën mirëpo rruga nga shitoret të cilat janë te kufiri e deri te hekurudha kryetari ka potencuar që pjesa e rrugës është private . Duhet të bëhet zgjidhje për këtë çështje.

**Rufki Suma** thekson:- kemi dashur me zgjeruar por figuron si pronë e terminalit doganorë dhe kemi bërë kërkesë për shpronësim.

**Florim Shkreta** thekson:- në momentin që bëhet kolonë duhet policia të jenë prezentë aty në mbarëvajtje të rendit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te lagjia nën hekurudhë rruga Lepenci balenat e ujit që janë për momentin nuk janë funksionalë dhe pronësia nuk e di kujt është por kemi problem për parking dhe është mirë me bërë edhe park për lojërë të fëmijëve.

**Rufki Suma** thekson:- është në pronësi të ujërave dhe kemi kërkuar që në kuadër të projektit me Bankën Botërore për lumin Lepenc me u rregulluar park për fëmijë dhe te ura e Seçishtë parashihet me u bërë shesh ajo pjesë.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- është marr vendim nga Ministria për ndërprerjen e aktiviteteve sportive dhe a është duke u zbatuar vendimi edhe në Han të Elezit për ndërprerjen e aktiviteteve sportive.

**Rufki Suma** thekson:- bëhet fjalë për aktivitete e mbyllura.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### 3. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- sa i përket përgjigjes së z.Sead Vila për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ndryshëm në trajnimin në Mavrovë, në konsultat që kam pasur me drejtori ka potencuar që zyrtarisht nuk kemi të drejtë me potencuar se komisioni ka përbërje politike sepse ligji e potencon që strukturat të jenë prej shoqërisë civile dhe në mënyrë interne janë përfshirë të gjitha subjektet politike dhe është përfshi nga një përfaqësues prej secilit subjekt politik.

**Mefail Suma** thekson:- për pyetjen që kam parashtruar për marrëveshjes që është bërë me Ministrin e Punëve të Brendshme për regjistrimin e automjeteve më është dërguar aneks marrëveshja andaj kërkoj kopjen e marrëveshjes. Është mirë që është dërguar kopja e marrëveshjes me kompaninë “Bifurkacioni” por një konfuzion që e kemi pasur ne si qytetarë dhe disa mashtrime që i ka pasur ekzekutivi sepse në bazë të marrëveshjes dhe në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale potencohet se komuna është e obliguar me siguruar ujë të pijes për qytetarët e jo “Bifurkacioni” apo dikush tjetër . A ka ndonjë marrëveshje tjetër përpos kësaj marrëveshje që është bërë me kompaninë “Bifurkacioni”. E parashtrojë këtë pyetje sepse uji shkon dhe akumulohet në rezervarë të cilët janë të Lagja Meliq dhe ai rezervarë ka qenë i Sallonitit dhe thuhet që ju është dhënë personave privatë. A ka marrëveshje kompania Bifurkacioni me pronarin privatë dhe e kompenzonë për ujin që akumulohet në rezervarë te Lagja Meliq. Në marrëveshje nuk shënon se cilat asete të komunës i shfrytëzon kompania “Bifurkacioni” dhe kontrata i ka skaduar dhe a do të ripërtërihet. Unë kërkoj që t i ndërpritet kontrata dhe ti ipet kompanisë pastrimi në menaxhim. Te uji problemi qalonë dhe nuk është puna me ja lënë fajin vetëm “Bifurkacionit” dhe më duket që marrëveshja me Bifurkacionin është bërë vetëm me punësuar dikend. Nga disa qytetarë jam informuar se janë disa banesa në Han të Elezit që nuk banonë askush dhe janë në emër të komunës. Kush i menaxhonë dhe kujt me ju drejtuar sepse ka qytetarë që kanë nevojë për banesë . Banesat e pabanueshme të cilat janë kujt me ju drejtuar për me shfrytëzuar banesën. Është marr vendim me ju dhënë pëlqimi dikujt për me ndërtuar te ish objekti “Sharri” një objekt dhe në momentin që është ndërruar kryetari komunës vendimi u shfuqizua dhe ajo pjesë i ka edhe 60 ari dhe kush i shfrytëzon ato prona a janë të uzurpuara. Unë e kam kërkuar listën e pasurisë për pronat e jo për vlerat 1000 € . Flitet se dikush ka marr iniciativë me ndërtuar banesa të mëdha dhe dikujt me i dhënë banesa e dikujt lokale, mirëpo për me dhënë pasurinë e komunës në shfrytëzim mundet me dhënë vetëm kuvendi i komunës.

**Kryesuesi** thekson:- për banesat e pabanueshme duhet të i drejtoheni Drejtorisë për Urbanizëm. Ju e dini se para disa viteve në Kuvendin e Komunës kërkesa ishte që QPS-ja dhe prona e z.Ramadan Bela dhe z.Zelqif Laçi me u ndërtuar një ndërtesë dhe ndërkohë u shfuqizua pëlqimi dhe u vendosë që me u ndërtuar objekti i Qendrës për Punë Sociale , mirëpo sot janë banorë edhe z.Zelqif Laçi edhe z.Ramadan Bela por prona është Komunale dhe janë banusë aty. Ata qe 50 vite i kanë shfrytëzuar dhe realisht duhet të jenë posedues të ligjshëm por nuk i kanë ndjekur procedurat dhe ato prona ende figurojnë në pronë komunale. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:08

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**

